



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 744/26
Data 29-07-26

Prishtinë, 10 korrik 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3291_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 28, paragrafi 1.28 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- Dispozitat e Nenit 1, paragrafi 3 të Rregullës për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike;
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafit 2 si dhe dispozitat e nenit 6 të Shtojcës 3 të Rregullës për të Hyrat e OSSH-së;
- Kërkesën e OSSH-së, për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit Investiv Një (1) për vitin 2026,

në seancën e mbajtur me datë 10 korrik 2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** - Plani Investiv Një (1) Vjeçar i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për vitin 2026.
- II. OBLIGOHET** – Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, që të zbatoj projektet e planifikuara sipas këtij Plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Shpërndarjes.

A r s y e t i m

- o Plani Investiv njëvjeçar për vitin 2026 është vlerësuar në përputhje me Rregullën për përgatitjen dhe vlerësimin e planeve zhvillimore dhe investive të operatorëve në sektorin e energjisë. Gjatë procesit të vlerësimit është analizuar arsyeshmëria teknike, ekonomike dhe rregullative e projekteve të propozuara, duke shqyrtuar nevojën për realizimin e tyre, prioritetet e zhvillimit të rrjetit, ndikimin në sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, si dhe përputhshmërinë me objektivat strategjike të sektorit. Ai është në harmoni të plotë me objektivat e Planit Investiv Pesëvjeçar (periudha e tretë rregullative 2023-2027), Planin Pesëvjeçar Zhvillimor të OSSH-së 2026-2030 dhe Planit Dhjetëvjeçar Zhvillimor të OSSH-së 2026-2035. Ky plan siguron vazhdimësinë e zbatimit të



investimeve të miratuara më parë, duke ruajtur koherencën e planifikimit investiv dhe duke respektuar parimet e efikasitetit ekonomik, përdorimit racional të burimeve financiare dhe qëndrueshmërisë së sistemit energjetik.

- Plani investiv njëvjeçar i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative, gjatë të cilit palët e interesuara dhe konsumatorët kanë pasur mundësinë të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre. Vetëm pas përfundimit të këtij procesi transparent dhe gjithëpërfshirës, Plani i është vënë në dispozicion Bordit të ZRRE-së për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.
- Investimet e parashikuara në këtë plan, me një vlerë totale prej 35,218,590 €, janë vlerësuar nga aspekti i arsyeshmërisë teknike dhe ekonomike, duke u bazuar në gjendjen e aseteve ekzistuese, nevojat për zhvillimin e rrjetit, projeksioneve të rritjes së kërkesës për energji elektrike, prioritetëve për reduktimin e humbjeve. Këto investime do të kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve, përmirësimin e parametrave të tensionit, rritjen e besueshmërisë, cilësisë dhe sigurisë së furnizimit dhe modernizimin digjital të rrjetit.
- Në fund të periudhës pesëvjeçare rregullative (2023-2027), efektet e zbatimit të këtij Plani, së bashku me investimet e tjera të realizuara gjatë kësaj periudhe, do të pasqyrohen plotësisht në bazën e rregulluar të aseteve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Kjo do të sigurojë një vlerësim të saktë të aktiveve të investuara, duke krijuar bazën e duhur për caktimin e të hyrave të ardhshme rregullatore dhe për ruajtjen e balancës midis interesave të konsumatorëve dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorit.
- Projektet kryesore të këtij plani përfshijnë, ndër të tjera, zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit në tension të mesëm dhe të ulët (duke përfshirë konvertimin në 20 kV), zhvillimin e rrjetit të mençur (SCADA, automatizim, GIS, FLISR), zëvendësimin e njehsorëve sipas kërkesave ligjore, si dhe përmirësimin e infrastrukturës IT dhe logjistikës.
- Këto ndërhyrje janë të arsyeshme dhe të nevojshme për përmbushjen e obligimeve ligjore të operatorit dhe objektivave të zhvillimit të sistemit të shpërndarjes, për të adresuar sfidat aktuale të sistemit, për të përmbushur standardet e cilësisë së shërbimit dhe për të përgatitur rrjetin e shpërndarjes për integrimin e burimeve të reja të energjisë, rritjen e kërkesës dhe hapjen e tregut të energjisë.
- Duke u bazuar në analizën e dokumentacionit të dorëzuar, rezultatet e procesit të konsultimit publik dhe vlerësimin e aspekteve teknike, ekonomike dhe rregullative, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji konstaton se projektet e përfshira në Planin Investiv Njëvjeçar për vitin 2026 janë të arsyeshme, të nevojshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet teknike dhe objektivat zhvillimore të sektorit të energjisë. Për rrjedhojë, Bordi vlerëson se janë plotësuar kushtet për miratimin e Planit Investiv Njëvjeçar të OSSH-së për vitin 2026, siç përcaktohet në dispozitivin e këtij Vendimi.


III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.





IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtare


Arta Isufi, Anëtar


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KEDS SH.A,
- Arkivit të ZRRE-së.